



Republika e Kosovës/  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija Statistike Kosova -  
Kosovo Agency of Statistics*

**Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

## **Anketa e mbeturinave komunale 2011**



Botuesi : Agjencia e Statistikave të Kosovës ( ASK)  
Data e botimit : Dhjetor 2012  
© Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.  
E shtypur nga: K.G.T Prishtinë, Kosovë

Informata më të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mundë të qaseni përmes web-faqes së ASK- së

Web-faqe: <http://esk.rks-gov.net/> dhe Tel.+381(0) 200 31-120

## Parathënie

Agjencioni i Statistikave të Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, për herë të pestë me radhë ka realizuar Anketën e Mbeturinave Komunale.

Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroj të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturinave Komunale në Kosovë.

Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Të gjitha instrumentet statistikore që janë përdorur për realizimin e anketës janë në harmoni me rregulloret dhe rekomandimet e BE, duke përfshirë edhe Ligjin e Mbeturinave në Kosovë (Nr .02/L-30).

ASK falënderon Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), ekspertët e Statistikave Suedeze për ofrimin e asistencës teknike, dhe këshilltaren afatëgjate të Statistikave Suedeze Zonjën Milva Ekonomi.

Publikim është përgatitur nga:

Bajrush Qevani, Drejtor DSB&M  
Mr.sc.Haki Kurti, Shef Divizioni DSB&M  
Arta Salihu - Morina, Zyrtare DSB&M

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe të dërgohen në:

E- mail: [agricultural@ks-gov.net](mailto:agricultural@ks-gov.net)

Dhjetor, 2012

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së

Isa Krasniqi

## Shkurtesat dhe Simbolet

BE	Bashkimi Evropian
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AKMM	Agjencioni Kosovar i Mbrojtjes së Mjedisit
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
KKP	Kompanitë Komunale Publike
DMD	Derë me Derë
BK	Banesa Kolektive
DSP	Departamenti i Statistikave të Popullsisë
DSBM	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DPSIR	Gjendja, Indikatorët, Treguesit, Presioni, Përgjegjësit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
EEA	Agjencioni Evropian për Mjedis

## Simbolet

Kg/banorë	Kilogram për banorë
kg	Kilogram
t	Ton

## Përmbajtja

	Faqe
Objektivat, metodologjia e anketës.....	5
Metodologjia .....	5
Procedurat në terren.....	6
Definicionet .....	6
Rezultatet.....	7
Tabela 1 .....	7
Tabela 2 .....	9
Krahasimi i të dhënave 2008-2011 .....	10
Tabela 3.....	10
Tabela 4.....	11
Aneksi 1 Pyetësi.....	13



## **Përmbajtja**

Anketa e mbeturinave Komunale, është realizuar sipas modelit DPSIR, i cili është i adoptuar nga grupi i shteteve të OECD-se, EUROSTAT, Agjencionit Evropian për Mjedis (EEA) dhe gjithashtu bazuar në regjistrin e indikatorëve mjedisor sipas EEA.

## **1. Objektivat, metodologjia e anketës**

### **1.1 Objektivat**

**Objektivi** i anketës së mbeturinave komunale, 2011 është që të sigurojë të dhëna statistikore për mbeturinat komunale sipas llojit të mbeturinave dhe sasisë së mbeturinave të grumbulluara. Gjithashtu ka pasur për qëllim që të siguroj bazën e monitorimit të mbeturinave komunale në të ardhmen në këtë sektor.

### **1.2 Metodologjia**

#### **1.2.1 Korniza e anketës**

Në Tetor 2012 janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për realizimin e anketës së AMK 2011 duke filluar nga:

Përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit, testimit të pyetësorit në kompani publike që merren me menaxhim të mbeturinave komunale, finalizimi i listës së kompanive të cilat merren me menaxhimin e mbeturinave komunale për para datës së fillimit të anketës, si dhe shpërndarja e materialit anketues sipas mostrës .

## 1.2.2 Procedurat në terren

Puna në terren është realizuar nga anketuesit të cilet kanë zhvilluar intervista të drejpërdrejta me menaxherët e kompanive në rajonin e tyre, duke u bazuar në pyetësorë (Aneksi1).

Kontrollimi i të dhënave është bërë në dy nivele:

- Kontrollimi i pyetësorëve të kompletuar në terren nga mbikqyrësit e terrenit.
- Kontrollimi i pyetësorëve të kompletuar në zyrën qendrore në ASK-së, nga stafi i sektorit të mjedisit.

## 2. Definicioni

**Mbeturinat Komunale** - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.




### 3. Rezultatet

**Tabela 1: Sasia e mbeturina komunale të grumbulluara sipas vendit të hudhjes 2011**

Vendi i grumbullimit	Banesa kolektive	DMD	Gjithsej
Njësia	1000 ton		
Prishtina dhe regjioni <sup>1</sup>	97	133	230
Regjionet tjera në Kosovë	145	207	352
Kosova Gjithsej	242	340	582


Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë për vitin 2011, ka qenë 582 000 ton.

**Grafiku 1: Struktura e mbeturinave të grumbulluara në vitin 2011**



<sup>1</sup> Prishtina, Obiliqi, Glogoci, Fushë Kosova, Lipjani, Graçanica, Podujeva dhe Novobërda

**Grafiku 2: Struktura e mbeturinave të grumbulluara për Prishtinën dhe Regjionin**



**Grafiku 3: Struktura e mbeturinave të grumbulluara për regjionet tjera në Kosovë**



**Tabela 2: Sasia e mbeturinave komunale për person në vitin 2011**

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar	Popullsia <sup>2</sup>	kg/banorë/vit	Mbeturina/banorë në ditë
Njësia	1000/ton			kg/banorë
Prishtina dhe regjioni	230	470.583	488	1,3
Regjionet tjera në Kosovë	352	1.269.242	278	0,8
Kosova gjithsej <sup>3</sup>	582	1.739.825	335	0,9

Në Kosovë të dhënat e vitit 2011 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të gjeneruara kanë qenë 335 kg për banorë në vit. Ndërsa dallime të theksuara vërehen ndërmjet regjioneve, si p.sh.në regjionet tjera në Kosovë sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara ka qenë 278 kg për banorë në vit.

Në Kosovë grumbullimi i mbeturinave derë më derë ishte 58 përqind, ndërsa në banimin kolektiv ka qenë 42 përqind.

Në regjionet tjera në Kosovë grumbullimi i mbeturinave komunale ishte në raport 41 përqind në banim kolektiv dhe 59 përqind në banim derë më derë.

Në Prishtinë dhe regjionin e sajë sasia e mbeturinave komunale ka qenë 1,3 kg në ditë për banorë. Për pjesën tjetër të Kosovës sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara për banorë në ditë ishte 0,8 kg (shiko tabelën 2).

<sup>2</sup> ASK të dhënat përfundimtare nga Regjistrimi i Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011.

<sup>3</sup> Kosova gjithsej; Nuk janë përfshirë të dhënat për komunat; Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq dhe një pjesë e komunës së Mitrovicës në regjistrimin e popullsisë 2011.

#### 4. Krahasimi i të dhënave në vitet 2008-2011 për mbeturinat komunale

**Tabela 3: Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë për banorë në ditë 2008- 2011**

Vendi i grumbullimit	2008			2009			2010			2011		
	Sasia e grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina/banorë/ditë	Sasia e grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina/banorë/ditë	Sasia e grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina/banorë/ditë	Sasia e grumbulluar	Mbeturina	Mbeturina/banorë/ditë
Njësia	1000/ton	Kg/ banorë		1000/ton	Kg/ banorë		1000/ton	Kg/ banorë		1000/ton	Kg/ banorë	
Prishtina dhe regjioni	198	396	0.9	218	436	1.2	222	511	1.4	230	488	1.3
Regjionet tjera në Kosovë	153	95	0.3	187	117	0.3	293	223	0.6	352	278	0.8
<b>Kosova gjithsej</b>	<b>351</b>	<b>167</b>	<b>0.5</b>	<b>405</b>	<b>193</b>	<b>0.5</b>	<b>515</b>	<b>297</b>	<b>0.8</b>	<b>582</b>	<b>335</b>	<b>0.9</b>

Në vitin 2011 grumbullimi i mbeturinave komunale i llogaritur për ditë për banorë në Prishtinë dhe regjionin e sajë ka qenë 1,3 kg, ndërsa në regjionet tjera në Kosovë 0,8 kg.

Në Kosovë, mesatarja e mbeturinave të grumbulluara për banorë në ditë ka qenë 0,9 kg

Në regjionet tjera në Kosovë të dhënat për vitin 2011 tregojn se ka pasur rritje në grumbullimin e mbeturinave për banorë për 20 përqind, krahasuar me vitin 2010.

**Tabela 4: Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë 2008-2011**

Vendi i grumbullimit	2008			2009			2010			2011		
	Banesa kolektive	Derë me derë	Gjithsej	Banesa kolektive	Derë me derë	Gjithsej	Banesa kolektive	Derë me derë	Gjithsej	Banesa kolektive	Derë me derë	Gjithsej
Njësia	1000/ton											
Prishtina dhe regjioni	82	116	198	98	120	218	92	130	222	97	133	230
Regjionet tjera në Kosovë	45	108	153	76	111	187	131	162	293	145	207	352
Kosova gjithsej	127	224	<b>351</b>	174	231	<b>405</b>	223	292	<b>515</b>	242	340	<b>582</b>

Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë nga kompanitë publike dhe private gjatë vitit 2011 është rritur për 13 përqind krahasuar me vitin 2010.

## **Aneks 1 Pyetësi**



**Tabela 1: Gjenerimi i mbeturinave komunale sipas llojit dhe sasisë (01.01–31.12.2011)**

Nr.	Komuna (emri)	Kodi komunal (plotësuar nga ASK)	Numri i zonave të operimit shfrytëzuar nga ndërmarrrja	Sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara sipas vendit të gjenerimit*		
				volumi ( ton)		GJITHSEJ
				BK	DMD	
a	1	2	3	4	5	6
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
	<b>GJITHSEJ</b>					

\*Shenim:

- Shënoni në kolonën 4 mbeturinat e grumbulluara nga banesat kolektive
- Shënoni në kolonën 5 mbeturinat e grumbulluara Derë më Derë, vlerëso me 0.2 ton një m<sup>3</sup> mbeturinë.





# Agjencia e statistikave të Kosovës

*përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit vepron edhe;** Zyra për regjistrimin e popullsisë ekonomike familjare dhe banesave si dhe **Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Numri i të punësuarve dhe buxheti akoma janë të limituar. Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%), Enti ka këtë strukturë kualifikuese, 65.4% me shkollim universitar ndaj 34.6% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Kemi realizuar me sukses në vitin 2011 projektin e Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe banesave, i cili regjistrim nuk është realizuar që nga viti 1981. Rezultatet e fituara nga ky regjistrim do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 143  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** [economic@ks-gov.net](mailto:economic@ks-gov.net)
- o **Ueb-faqe:** <http://esk.rks-gov.net>